

## AKT THEMELIMI

### I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### “D&M INVESTMENTS” SHPK

Ortakët themelues të Shoqërisë :

**Z. Mauro MORELLI**, shtetas Italian, lindur në Napoli me 28.05.1977, i identifikuar me ID nr.CA67182NP. Banus rruga Ugo Palermo nr.3 Napoli (NA) Itali

**Z. Dario FREZZA**, shtetas Italian, lindur me 23.08.1978, në Borgo Sanmarino (AL) – Itali dhe banues në Borgo Sanmarino (AL) rruga IV Novembre nr 9 i identifikuar me Karte Identiteti nr. nr. Ar 9589963 bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”,

mbledhur në Tiranë sot më datë 13/2/2024

### VENDOSËN:

Të krijojnë së bashku një shoqëri tregtare dhe për këtë qëllim hartojnë dhe miratojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

#### NENI 1.

##### Emri

**1.1** Shoqëria do të paraqitet në qarkullimin tregtar me emërtimin e saj “D&M INVESTMENTS” SHPK

**1.2** Ndryshimi i emrit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të saj.



## **NENI 2**

### **Forma juridike**

**2.1** Shoqëria tregtare **“D&M INVESTMENTS” SHPK** ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

**2.2** Shoqëria mund të transformohet në një formë tjetër juridike me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të ortakëve sipas përcaktimeve në ligj dhe në Statutin e saj.

## **NENI 3**

### **Selia**

**3.1** Selia e Shoqërisë ndodhet në Rrugen **Rrapo Hekali p.llt Dejani Hyrja nr. 2 App nr 7. Tirane** Njesia Bashkiake nr 13 Tirane

**3.2** Ndryshimi i selisë së shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të Shoqërisë.

**3.3** Me vendim të Asamblesë së Ortakëve shoqëria mund të hapë degë të saj apo Zyra përfaqësimi në qytete të tjera apo dhe jashtë Shqipërisë.

## **NENI 4**

### **Vula e shoqërisë**

**4.1** Shoqëria do të ketë vulën e saj.

**4.2** Forma e vulës dhe masa e saj do të përcaktohen nga Asambleja e ortakëve në përputhje me legjislacionin shqiptar;

## **NENI 5**

### **Objekti i Veprimtarisë**

**5.1** Shoqëria ka si objekt veprimtaritë si më poshtë:



- - *Konsulence e medicione financiare import eksport dhe tregetim me shumice dhe pakice te artikujve te ndryshem industriale, hidrokarbure, imobiliare, ushqimore, bujqesore, tregteti farmaceutike, zhvillim te ketij aktiviteti dhe ne vende te tjera ne europe;*

5.2 Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me rregullat në fuqi.

## NENI 6

### Kohëzgjatja e Shoqërisë.

6.1 Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje për një afat të pacaktuar.

6.2 Shoqëria ka personalitet juridik duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

## Neni 7

### Kapitali i shoqërisë dhe Kuotat

7.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është i përbërë nga kontributi në para i ortakëve në vlerën 100.000 lekë.

- **Z. Mauro MORELLI** zotëron një kuotë me vlerë 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë, që përfaqëson 50 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
- **Z. Dario FREZZA** zotëron një kuotë me vlerë 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë, që përfaqëson 50 % të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

7.2 Ortakët, në bazë të kërkesës së organit administrues, mund të sjellin para në shoqëri sipas marrëveshjes paraprake të lidhur midis tyre. Kjo derdhje parash mund të bëhet në formën e zmadhimit të kapitalit ashtu si

dhe në formën e financimit të shoqërisë. Në rastin e financimit të shoqërisë nga ortakët në formë huaje, nuk është e nevojshme të respektohet përpjeshtëmëria mes shumës së derdhur në shoqëri dhe kuotave të kapitalit që ortakët zotërojnë.

7.3 Nëse mes palëve nuk ka akorde specifike, financimet në formë huaje të bëra nga Ortakët do të konsiderohen si hua pa interes.

## **NENI 8**

### **Organet e Shoqërisë**

8.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

8.2 Kompetencat, të drejtat dhe detyrat e këtyre organeve do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

## **NENI 9**

### **Administratori**

9.1 Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohen dhe shkarkohen nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje.

9.2 Administrator i Shoqërisë do të jetë **Z. Mauro MORELLI**, lindur në Napoli me 28.05.1977, i identifikuar me ID nr.CA67182NP. Banus rruga Ugo Palermo nr.3 Napoli (NA) Itali

## **NENI 10**

### **Dispozita të fundit**



Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me Aktin e Themelimit, Statutin dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi. Përsa nuk parashikohet në Aktin e Themelimit, dhe në Statut, do të zbatohen kryesisht dispozitat e ligjit «Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare», Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi.

## NENI 11

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t'i drejtohet për zgjidhje Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

*Ky Akt themelimi përpilohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore, njëra nga të cilat qëndron në dokumentacionin bazë të shoqërisë.*

### ORTAKËT THEMELUES

MAMO MORILLI

D. P. R. O. F. R. E. Z. Z. A

D.F.